

KOMUNIKATE

Komisioni i grevës së studentëve të UTSë dhe Instituteve të Lartë të Tiranës njofton opinionin publik mbarë kombëtar në mbledhje të kërkesës së tyre të drejtë për heqjen e emrit të universitetit. Qindra studentë e pedagogë u mbledhën sot në grevë urie në ambientet e brendshme të qytetit studentit.

Kjo ngjarje e pa precedentë në historinë e Shqipërisë është pasojë e drejtpërdrejtë e qëndrimit që kanë mbajtur ndaj protestave tona autoritetet përkatëse. Dy javë me rradhë ne bojkotuar mësimin dhe u përpoqëm të gjenim rrugën më demokratike për zgjedhjen e problemit. Dy javë me rradhë sheshi demokracia puçiti nga brohoritjet, dy javë me rradhë ne argumentuam në menyrë bindëse se heqje e emrit nuk është kapriço por domosdoshmëri. E për të gjitha këto morëm si përgjigje nga qeveria një vendim apatik, jo realist që më tepër se sa e shuan siç pretendon, e nxit tensionin.

Vëllezer dhe motra,

Ditët heroike të dhjetorit na mesuan të jemi të vendosur t'i njohim të drejtat tona dhe mos ti kapërcejme ato si engjëj bartës të demokracisë, studentët janë të bindur që ta cojnë deri në fund rrugën e tyre, atë që i hapi pluralizimit rreth 16 vjet të ndryshkura të Shqipërisë. Ndryshe demokracia do mbetet [?], ndryshe ju vetë do të na quanit të dobët dhe historia do të na ndeshkojë. Në këto ditë kur e ardhmja e atdheut na rendon fort mbi supë, ne e ndjejmë se vetëm me demokraci reale mund të jetë shpëtimtare për të. Dhe heqje e emrit të universitetit si një vendim i padrejtë i së shkuarës është kusht bazë për demokracinë.

Prindër, vëllezer dhe motra,

Me vendosmëri por edhe pa dhimbje ne ju themi se sot nuk do të kthehemi si përherë në vatrën familjare. Nuk do të kthehemi as në mbremje. Ndoshta do t'iu mungojmë për ditë me rradhë. Dhe jemi të bindur që kjo kujtesë do tu bëjë juve më krenarë.

Ndaj ju lutemi mos u merakosni, mos u largoni nga shtëpia dhe punët tuaja për të na bërë thirrje të heqim dorë. Ju po aq mirë sa ne e dini se Universiteti nuk ngrihet kot. Ndryshoni shqetësimin tuaj në vetvete ashtu si në ditët e dhjetorit, kur ndërsa na percillnit, duke na bindur të mos ndaheshim nga shoket, uronit që endrrat tona të mos mbeteshin vetëm të tilla.